

**VENDIM**  
**Nr. 683, datë 6.12.2023**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR**  
**FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË**  
**INFRASTRUKTURËS PUBLIKE NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR**  
**ZHVILLIM TË DETYRUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 3.4, të vendimit nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3.5, me këtë përmbajtje:

“3.5 Përveç përcaktimeve të pikës 3.4 të këtij vendimi, fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit të 2023, do të jetë në masën 528 451 028 (pesëqind e njëzet e tetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e njëzet e tetë) lekë pa TVSH, nga i cili:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 305 255 685 (treqind e pesë milionë e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë) lekësh pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë;

b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi prej 223 195 343 (dyqind e njëzet e tre milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzet e tre) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim në Bashkinë Tiranë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**